

UDHËZIM
Nr. 9, datë 21.3.2023

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 5.7.2022, “PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, pas nenit 9, të shtohen neni 9/1 dhe neni 9/2 me përmbajtje, si më poshtë:

Neni 9/1

“Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit artistik”

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Për të gjitha lëndët e kurrikulës artistike, vlerësimi realizohet në dy periudha, si më poshtë:

a) periudha e parë: shtator – janar;

b) periudha e dytë: shkurt – qershor.

3. Dokumentimi në regjistrë i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve për lëndët e kurrikulës artistike sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë” dhe “Koreografi”, të jetë si më poshtë:

Periudha e parë		Periudha e dytë		Vlerësimi vjetor		Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmblledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmblledhëse (saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmblledhëse (saxho)	

4. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

5. Procedura për përlogaritjen e notës përfundimtare vjetore, është:

a) nota vjetore e vlerësimit të vazhduar teknik përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teknik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

b) nota vjetore e detyrës përmblledhëse (saxho) përcaktohet bazuar në dy notat e detyrës përmblledhëse (saxho) të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive;

c) nota përfundimtare përcaktohet bazuar në notën vjetore të vlerësimit të vazhduar teknik dhe notën vjetore të detyrës përmblledhëse (saxho).

6. Dokumentimi në regjistrë i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve për lëndët e kurrikulës artistike, sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik, në degën “Art figurativ”, është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	

7. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.

8. Nota përfundimtare përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teorik dhe praktik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.

9. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë”, “Koreografi” dhe “Art figurativ” vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

Neni 9/2

“Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit sportiv”

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

2. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit sportiv vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi